



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 15Nr.345/02-33605 e datës 30.06.2023 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 duke vendosur sipas kërkesës nr.01-020/04-12994 të datës 24.03.2025 të Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR CAKTIMIN E LOKACIONEVE PËR
TRANSPORTIN E UDHËTARËVE ME AUTOMJETE TAKSI

Neni 1

Përbërja e Komisionit

Me qëllim të kryerjes së veprimtarisë së bartjes së udhëtarëve me automjete taksi, formohet Komisioni për caktimin e lokacioneve për qëndrimin e auto taksive në qytetin e Lipjanit, në këtë përbërje :

1. Jetmir Bytyqi, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Kryesues
2. Rrahman Olluri, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar
3. Gafurr Hetemi, Sektori pronësor-juridik, anëtar
4. Bujar Curri, Drejtorati për Inspektorat, anëtar
5. Ramadan Hoxha, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni në pajtim me Rregulloren për transportin e udhëtarëve me automjete taksi, ka për detyrë që të bëjë përcaktimin e lokacioneve për qëndrimin e auto taksive në qytetin e Lipjanit si dhe numrin e automjeteve që mund të vendosen në këto lokacione.
2. Komisioni detyrat e cekura në paragrafin e parë të këtij neni do ti kryej më së largu deri me datë 10.04.2025 duke ia propozuar Kryetarit të Komunës për miratim lokacionet e mundshme i cili përkitazi me këtë do të nxjerr Vendim konform Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 15Nr.345/02-33605 e datës 30.06.2023.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë me kopjen e të cilit do të njoftohen Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr.020/04-12994
Lipjan, më 27.03.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, duke vendosur sipas kërkesës së Drejtoratit për Shërbime, Publike , Mbrojtje dhe Shpëtim të datës 05.03.2025, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

I. Me këtë Vendim, formohet Komisioni i përkohshëm ad.hoc për evidentimin dhe regjistrimin e gjendjes aktuale të aseteve të cilat kanë qenë në shfrytëzim paraprak nga ana e KRM "Pastrimi" sipas kontratës me titull "Menaxhimi i tregjeve të Lipjanit" e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit si autoritet kontraktues dhe KRM "Pastrimi" SH.A si ofrues i shërbimeve e cila kontratë është para përfundimit .

II.Komisioni do të ketë këtë përbërje:

1. Xhelil Murati, Drejtorati për Shërbime , Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Kryesues
2. Bedri Hetemi , Drejtorati për Inspeksion, anëtar
3. Përfaqësues i dërguar nga KRM " Pastrimi" anëtar

III. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni kam për detyrë dhe përgjegjësi që të bëjë evidentimin dhe regjistrimin e gjendjes aktuale të aseteve të cilat kanë qenë në shfrytëzim paraprak nga ana e KRM "Pastrimi" sipas kontratës me titull "Menaxhimi i tregjeve të Lipjanit" e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit si autoritet kontraktues dhe KRM "Pastrimi" SH.A si ofrues i shërbimeve e cila kontratë është para përfundimit.

Komisioni detyrat e cekura do ti kryej më së largu me datë 12.03.2025 dhe lidhur me këtë duhet të hartoj raport me shkrim me të cilin duhet ta njoftoj Kryetarin e Komunës, Drejtoratin për Prokurim dhe Menaxherin e Kontratës .

IV. Komisioni ka mandat të përkohshëm dhe me përfundimin e detyrave të cekura pushon edhe mandati i tij.

V. Me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi me anëtarët e Komisionit, Drejtori i Drejtoratit për Prokurim dhe Menaxheri i Kontratës Enver Elshani.

VI. Vendimi hyn në fuqi menjëherë .

1Nr.020/04-10111
Lipjan, më 05.03.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, si dhe Rregullores për Transparencën në Komunën e Lipjanit 15Nr.-016/01-63314 e datës 26.12.2024, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR DRAFT – PLANIN E VEPRIMIT KOMUNAL PËR STREHIM FAMILJAR PËR KOMUNËN E LIPJANIT 2025-2027

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Draft –. Plani i Veprimit Komunal për Strehim Familjar për Komunën e Lipjanit 2025-2027

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet për Draft – Planin e Veprimit Komunal për Strehim Familjar për Komunën e Lipjanit 2025-2027 mund t'i dërgohen Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ose në email adresën shkelzen.hajdini@rks-gov.net, më së largu me datë 26.03.2025.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës.

1Nr. 360/09-10976
Lipjan, më 11.03.2025

KRYETARI KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Na osnovu članova 13, 58 i 68 stav 68.4 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br.03/L-040, Službena Novina Republike Kosova, br.28 dt. 4 juni 2008, članova 40, 41 i 67 Statuta Opštine Lipjan 15Br.110-78095 dt. 24.12.2021, Administrativno Upustva (MUP) Br.04/2023 za u pravu open u open u opštini, Uredba o Transparentnosti u Opštini Lipjan, Br. 15-016/01-63314 dt.26.12.2024, Predsednik Opštine donosi:

ODLUKA

O JAVNOJ KONSULTACIJI ZA PROJEKT- OPŠTINSKI AKCIONI PLAN ZA PORODIČNO SKLONIŠTE ZA OPŠTINU LIPLJAN 2025-2027

Član 1

U cilju sprovođenja konsultacija i učešća javnosti, u usvajanju akata iz nadležnosti Opštine, objaviti na Websajt Opštine:

Projekt - Opštinski Akcioni Plan Za Porodično Sklonište Za Opštinu Lipjan 2025-2027.

Član 2

Primedbe i sugestije na ovaj Projekt – Opštinski Akcioni Plan Za Porodično Sklonište Za Opštinu Lipjan 2025-2027, mogu se poslati Direkcije za Zdravstvenu i Socijalnu Zaštitu na email adresu: shkelzen.hajdini@rks-gov.net naj kasnije do 26.03.2025.

Član 3

Ova Odluka stupa na snagu danom usvajanja i biće objavljena na Websajt Opštine.

1Br. 360/09-10976
Lipljan, 11.03.2025

PREDSEDNIK OPŠTINE

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, si dhe Rregullores për Transparencën në Komunën e Lipjanit 15Nr.-016/01-63314 e datës 26.12.2024, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR DRAFT – STRATEGJINË PËR ZHVILLIMIN DHE FUQIZIMIN E RINISË NË KOMUNËN E LIPJANIT 2025-2030

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Draft – Strategjia për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në Komunën e Lipjanit 2025-2030

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet për Draft – Strategjinë për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në Komunën e Lipjanit 2025-2030, mund t'i dërgohen Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport ose në email adresën Anila.Reqica.Llugiqi@rks-gov.net, më së largu me datë 01.04.2025.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës.

1Nr. 016/01-11924
Lipjan, më 17.03.2025





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Na osnovu članova 13, 58 i 68 stav 68.4 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br.03/L-040, Službena Novina Republike Kosova, br.28 dt. 4 juni 2008, članova 40, 41 i 67 Statuta Opštine Lipljan 15Br.110-78095 dt. 24.12.2021, Administrativno Upustva (MUP) Br.04/2023 za u pravu open u open u opštini, Uredba o Transparentnosti u Opštini Lipljan, Br. 15-016/01-63314 dt.26.12.2024, Predsednik Opštine donosi:

ODLUKA

O JAVNOJ KONSULTACIJI ZA PROJEKT- STRATEGIJA ZA RAZVOJ I OSNAŽIVANJE MLADIH U OPŠTINI LIPLJAN 2025-2030

Član 1

U cilju sprovođenja konsultacija i učešća javnosti, u usvajanju akata iz nadležnosti Opštine, objaviti na Websajt Opštine:

Projekt - Strategija za razvoj i osnaživanje mladih u opštini Lipljan 2025-2030.

Član 2

Primedbe i sugestije na ovaj Projekt – Strategija za razvoj i osnaživanje mladih u opštini Lipljan 2025-2030, mogu se poslati Direkcije za Kulturu, Omladinu I Sport na email adresu: Anila.Regica.Llugiqi@rks-gov.net do 01.04.2027.

Član 3

Ova Odluka stupa na snagu danom usvajanja i biće objavljena na Websajt Opštine.

1Br. 016/01-11924
Lipljan, 17.03.2025





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **8,400.00€**, (tetë mijë e katërqindë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-9669 e datës 03.03.2025, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 30 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin shkurt të vitit 2025 me nga 280 euro për secilin rast $30 \times 280 = 8,400.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2025, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryeatrit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-9669
Lipjan, më 04.03.2025

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, nenit 4 dhe 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, duke vendosur sipas kërkesës 1Nr.400/01-9198 të datës 27.02.2025 të Bashkësisë Islame dega në Lipjan, Kryetari i Komunes nxjerr këtë:

VENDIM PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 1500€ (një mijë e pesqindë euro), Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan, për të mbështetur financiarisht për realizimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore fetare dhe humane për nderë të muajit "Ramazan", sipas kërkesës së tyre të paraqitur 1Nr.400/01-9198 të datës 27.02.2025.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2025 pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në xhirollogarinë bankare të Bashkësisë Islame në nr. 1719200019037882 në NLB Bankë.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara i lartëcekuri duhet të sjell raportin financiar dhe të njëjtin të dorëzojë në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport më së largu me datë 25.12.2025.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet BIK-u dega në Lipjani.

1Nr.400/01-9198
Lipjan, më 04.03.2025.

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Vendimit të Asociacionit të Komunave të Kosovës të datës 23.09.2020, Kryetari i Komunes, nxjerr

**VENDIM
PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE**

Neni 1

Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej 8640,75 € (tetë mijë e gjashtëqind e katërdhjetë euro e shtatëdhjetë e pesë cent), për pagesën e anëtarësisë në Asociacionin e Komunave të Kosovës në pajtim me Vendimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës – AKK të datës 23.09.2020, Njoftimit të AKK për kodin ekonomik dhe faturës nr:17/25 të datës 28.01.2025.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2025, kategoria ekonomike – mallra dhe shërbime të Drejtoratit për Administratë në xhirollogarinë bankare nr.1901586841031197 në Bankën Kombëtare Tregtare BKT.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 400/01-10605
Lipjan, më 28/03/2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 duke u bazuar në Marrëveshjen e bashkëpunimit Nr.01-352/02-60105 të datës 05.12.2024, lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës International Organization For Migration (IOM), Kryetari i Komunes, nxjerr:

VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

I. Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve më vlerë prej **9.966.00 € (nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro)**, konform dispozitave të Marrëveshjes e bashkëpunimit Nr.01-352/02-60105 të datës 05.12.2024, lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës International Organization For Migration (IOM), për projektin e zbatimit të rregullimit të disa rrugëve në Komunën e Lipjanit sipas dispozitave të Marrëveshjes së bashkëpunimit.

II. Shuma e cekur në pikën I të këtij Vendimi transferohet me qëllim të përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes e bashkëpunimit Nr.01-352/02-60105 të datës 05.12.2024, lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës International Organization For Migration (IOM).

III. Shuma e cekur nga neni I do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2025, Fondi për bashkëfinancim me donatorë në xhirollogarinë bankare të Organizatës International Organization For Migration (IOM), me nr. 1501001000419617 në Raiffeisen Bank.

IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra Lokale për Komunitete, Drejtorati për Infrastrukturë dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 400/01-12483
Lipjan, më 20.03.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

